



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETQEVERISËSE
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT



QEVERIA E KOSOVES / MINISTERIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKALE
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO LOKALNE SAMOUPRAVE I ADMINISTRACIJE
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

Në pajtim me nenin 1.3 pika (d) e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 Mbi Degën e Institucioneve të Përkohëshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Rregullores 2005/15 Për Ndryshimin e Rregullores 2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohëshme të Vetëqeverisjes, Rregullores 2000/45 neni 32 si dhe Urdhëresa Administrative 2003/2 për Zbatimin e Rregullores 2001/36 Mbi shërbimin civil të Kosovës neni 28.1, 28.2 dhe 28.3. Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokalë nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MAPL - NR-2007/07 MAPL

PËR KUFIZIMIN E VEPRIMTARISË POLITIKE TË SHËRBYESVE CIVIL KOMUNAL

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim kufizimin e veprimtarisë politike të shërbyesve civil komunal, që nga momenti i themelimit të marrdhënjes së punës në shërbimin civil komunal.

Neni 2 Përkufizimet

Në kuptimin e këtij udhëzimi administrativ termat e mëposhtme kanë këtë kuptim:

Shërbyes civil komunal: do të thotë çdo person i punësuar i një organi në administratën komunale, rroga e të cilit paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës marrëdhënia e punës e të cilit rregullohet nga legjislacioni mbi shërbimin civil në Kosovë,

Shërbyes i lartë civil komunal : nënkupton kryeshefin ekzekutiv, drejtorin e drejtorisë komunale drejtorin e zyrave, udhëheqësit e sektorëve, drejtorët e shkollave dhe drejtorët e Qendra të Kujdesit Mjekësor Familiar,

UNLESE - IZJANA - UDHËZIM	
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokalë	
Ministry of local government administration	
Nr. / No.	02 - 649
Data / Datum	06.09.2007

Post politik: nënkupton pozitën e kryetarit dhe nënkryetarit të kuvendit të komunsë dhe anëtarët e kuvendit të komunës;

Anëtar partie: personi fizik që është i pajisur me kartelë identifikuese të ndonjë partie ose organizate politike.

Anëtar kryesie: çdo person fizik që është në anëtarë i kryesisë së qendrës dhe/ose degës të një partie politike.

Post udhëheqëse në një parti politike: nënkupton kryetarin, nënkryetarin, sekretarin dhe zëdhënësin e partisë politike të qendrës dhe degës.

Aktivitet politik: kuptohet çdo veprim, përmes të të cilit manifestohet propagandë politike ose bëhet fushatë për një subjekt politik.

Neni 3

Shërbyesit civil komunal mund të jenë anëtarë të thjeshtë të partive dhe organizatave të tjera politike, por nuk mund të jenë në të njëjtën kohë në pozita udhëheqëse në atë parti ose organizate.

Neni 4

Shërbyesi civil komunal nuk mund të kryejnë aktivitete partiake gjatë kryerjes së punës së tij në shërbimin civil dhe duhet të ruajë paanësinë politike.

Neni 5

Shërbyesit civil, duke përfshirë edhe shërbyesit e lartë civil të cilët janë të punësuar në administratën komunale, nuk mund të jenë në të njëjtën kohë edhe anëtarë të kuvendit të komunës në të cilën kanë marrëdhënie pune.

Neni 6

Shërbyesit civil komunal kur paraqesin kandidaturen për ndonjë funksion të zgjedhur publik ai ose ajo duhet të marrin pushim pa pagesë pesëmbëdhjetë (15) ditë para fushatës parazgjedhore, me qëllim që të lirohet nga përgjegjësitë dhe obligimet në shërbimin civil komunal.

Neni 7

Shërbyesit civil komunal duke përfshirë edhe shërbyesit e lartë civil komunal gjatë orarit të punës i ndalohej të marrë pjesë në fushata parazgjedhore.

Neni 8

Shërbyesi civil komunal me rastin e dhënies së betimit si anëtar i kuvendit të komunës ose pas pranimit të postit politik, është i obliguar automatikisht të jep dorëheqje nga shërbimi civil komunal.

Neni 9

Shërbyesi civil komunal të cilët kandidojnë për ndonjë funksion publik, kanë të drejtë të kthehen në punën e tyre brenda (1) jave nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, në rast të mos zgjedhjes për postin publik në të cilin kanë kandiduar.

Neni 10

Ndaj shërbyesve civil komunal që nuk zbatojnë dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ do të merren masa ndëshkimore sipas legjislacionit të shërbimit civil.

Neni 11

Monitorimin e implementimit të këtij Udhëzimi Administrativ do ta bëjë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 12

Ky udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, nga Ministri i i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Prishtinë
05 shtator 2007


Lutfi Haziri

Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal